



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E DOGANAVE
DEGA E DOGANËS SHKODËR

Nr. 1334/2 Prot.

Shkodër, më 22.10.2023

LËNDA: Kërkesë për shpallje publike

DREJTORIA E PËRGJITHSHME E DOGANAVE
DEPARTAMENTI I ANALIZAVE DHE APOSTERIORIT
SEKTORI I MONITORIMIT TË BORXHIT

DREJTORIA E BURIMEVE MBËSHTETËSE ✓

Adresa: Tiranë, Kashar Mëzez, Lagjia Fushë Mëzez, autostrada Tiranë-Durrës, km 1,
Qendra "Pajtoni Bussines Center", kati 5.

Bazuar në nenin 96 të Ligjit Nr. 102/2014, datë 31.7.2014 "Kodi Doganor Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar dhe pikës 4 të nenit 162 të Ligjit Nr. 44/2015, datë 30.04.2015 "Kodit të Procedurës Administrative i Republikës së Shqipërisë", 4. "...organi publik publikon aktin në faqen e tij të internetit dhe ..." kërkojmë shpalljen publike për;

- Vendimin administrativ Nr. 30 datë 31.07.2023 ndaj debitorit subjektit "SaAndr" sh.p.k, me NIPT L36904002U, me adresë në: Shkodër Lagjia Skenderbeg, Rruga Çerçiz Topulli, godine 3-kateshe, kati 1-re dhe 2-te, nr. pasurie 13/237, zona kadastrale 8593.

Për vazhdimin e procedurave ligjore për rikuperimin e borxhit doganor është domosdoshmëri data e shpalljes publike.

Ju falënderojmë për bashkëpunimin.

KRYETAR

Aida DIZDARI



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCAVE DHE E EKONOMISË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E DOGANAVE
DEGA E DOGANËS SHKODËR

Nr. 855/ Prot.

Shkodër, më 31.07./2023

V E N D I M
Nr. 30, datë 31.07.2023

Autoriteti vendimmarrës i Degës Doganës Shkodër, morri në shqyrtim procesverbalin për verifikimin e kundërvajtjeve administrative doganore Nr. 855/1 prot., datë 13.06.2023, të mbajtur nga doganierja e regjimeve dhe përgjegjësjë e Zyrës së Regjimeve Shkodër, lidhur me konstatimet e bëra të subjektit “SaAndr” sh.p.k, me NIPT L36904002U, me adresë në: Shkodër Lagjja Skenderbeg, Rruga Çerçiz Topulli, godine 3-kateshe, kati 1-re dhe 2-te, nr. pasurie 13/237, zona kadastrale 8593.

Në analizim dhe shqyrtim të gjithë situatës së krijuar, u mbajt procesverbali me Nr.855/1 prot., datë 13.06.2023 nga grupi i punës pranë Degës së Doganës Shkodër dhe u konstatua se:

Subjekti “SAANDR” sh.p.k, me NIPT L36904002U i cili ka punuar nën “Regjimin e Përpunimit Aktiv” me autorizimin me Nr. 12045/1, datë 05.11.2020 dhe Nr.5897/1 datë 16.11.2021 të lëshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave. Nisur nga fakti se tashmë me këto autorizime subjekti nuk mund të kryej asnjë veprim, nga ana jonë po shqyrtohen këto dy autorizime. (sipas tabelës Nr. 1 dhe Nr. 2).

Tabela Nr.1. Autorizim Nr.5897/1 datë 16.11.2021

<i>Procedura</i>	<i>Emertimi I mallit</i>	<i>Sasia (cope</i>	<i>Vlera (Euro)</i>	<i>P.sha kg</i>	<i>TDP</i>
<i>Importe</i>	Materiale për prodhimin e konfeksioneve		46.453.59	2.420.82	4.082
<i>Exporte</i>	Konfeksione të ndryshme	1.555	46.453.9	2.23	Tere exp. Pa EURO-1
<i>Import 9</i>	0			0	
<i>Gjendja</i>	0		0	190.82	0

Siç vërehet nga tabela Nr.1, subjekti tërë sasisë së mallit të importuar, i ka dhënë një destinacion doganor në sasi dhe vlerë.

Peshës prej 190.92 kg, nuk i ka dhënë dhënë destinacion. Kjo peshë, së bashku më peshën prej 190.92 kg përbën 15 % të sasisë totale të importuar dhe përpunuar, peshë e cila është brenda kufijve të koeficientit. (Totali i peshës së importuar dhe përpunuar është 2421kg – 1180kg = 1241kg).

Subjekti nuk ka dorëzuar dokumentin e mbylljes se regjimit, detyrim te cilin është dashur ta kryej deri me date 23.03.2023.

Tabela Nr.2. Autorizim Nr.12045/1 datë 05.11.2020

<i>Procedura</i>	<i>Emertimi I mallit</i>	<i>Sasia (cope</i>	<i>Vlera (Euro)</i>	<i>Pesha kg</i>	<i>TDP</i>
<i>Importe</i>	Materiale per prodhimin e konfeksioneve		486.961.62	26.753.8	79.259
<i>Exporte</i>	Konfeksione të ndryshme	51.681	486.961.6	21.249	0

	0	740	
0	0	4.764.8	79.259

...erchet nga tabela Nr.2, subjekti tërë sasisë së mallit të importuar, i ka dhënë një destinacion doganor në sasi dhe vlerë.
Peshës prej 4.76.8 kg, nuk i ka dhënë nuk i ka dhënë destinacion. Kjo peshë, së bashku me peshën prej 4.76.8 kg përbën 20 % të sasisë totale të importuar, peshë e cila është brenda kufijve të koeficientit.

Nga ana e subjektit nuk është dorëzuar asnjë tabelë TDP. (Aneksi 6 i Udhëzimit të RPA-së, ku të justifikohet mospagesa e TDP, në sasinë prej 79.259 lekë, e cila duhej të ishte paguar ne momentin e rieksporimit.

Gjithashtu, subjekti nuk ka dorëzuar dokumentin e mbylljes së regjimit, detyrim të cilin është dashur ta kryej deri me datë 23.03.2023.

Në zbatim të pikës 4, të nenit 273 të Ligjit Nr. 102/2014, datë 31.07.2014 “Kodi Doganor Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe neneve 47, e vijues të Kodit të Procedurës Administrative, dega doganore me shkresën nr. 855/2 prot., datë 13.06.2023, ka njoftuar subjektin për procesverbalin nr. 855/1, të mbajtur nga grupi i punës pranë degës, sipas lajmërim marrjes me kod RR 449 029 460 AA, dhe me shkresë Nr.855/3prot., datë 03.07.2023.

Përsa më sipër, autoriteti vendimmarrës i Degës Doganore Shkodër gjen të drejtë zbatimin e germës “i”, të nenit 251, germës “c”, të nenit 252, germës “b”, pika 1 të nenit 256 germës “a,b”, të nenit 257 të Ligjit Nr.102/2014 datë 31.07.2014 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar, Udhëzimit nr.04 datë 28.03.2019 “Për zbatimin praktik të Regjimit të Përpunimit Aktiv” dhe;

V E N D O S I:

1. Shpalljen debitor të subjektit “SAANDR” sh.p.k, me NIPT L36904002U për shkeljen e konstatuar në autorizimin e RPA-së Nr. 12045/1, datë 05.11.2020 dhe Nr.5897/1 datë 16.11.2021, si më poshtë vijon;

- Për mos dhënien destinacion doganor tërë sasinë e mallit për autorizimin Nr.5897/1 datë 16.11.2021, në kundërshtim me germën (c), të nenit 252 dhe aplikimin e sanksioneve bazuar në germën (b) të nenit 257 të Kodit Doganor në shumën 50.000 (pesëdhjetëmijë) lekë.
- Për mosdorëzimin e dokumentit të mbylljes së regjimit, në kundërshtim me nenin 251, germa (b) pika 1 të nenit 256 të Kodit Doganor në shumën 20.000 (njëzetmijë) lekë.
- Për mos dhënien destinacion doganor tërë sasinë e mallit për autorizimin Nr. 12045/1, datë 05.11.2020, në kundërshtim me germën (c), të nenit 252 dhe aplikimin e sanksioneve bazuar në germën (b) të nenit 257 të Kodit Doganor në shumën 50.000 (pesëdhjetëmijë) lekë.
- Për mos pagesën e taksës doganore preferenciale TDP, në kundërshtim me germën c, nenit 252 dhe aplikimin e sanksioneve bazuar në germën a, pika 1, e nenit 257 të Kodit Doganor.

Detyrim doganor	79.259 lekë
Gjobë 2 – fish i detyrimit doganor	158.518 lekë
Shuma	237.777 lekë

mosdorëzimin e dokumentit të mbyljes së regjimit, në kundërshtim me nenin 251, germa (b) pika 1 të nenit 256 të Kodit Doganor në shumën **20.000** (njëzetmijë) lekë.

Në total, në shumën prej 377.777 lekë (treqindeshtatëdhjeteshtatë mijë e shtatëqindeshtatëdhjeteshtatë) lekë.

2. Një kopje e këtij vendimi i dërgohet Zyrës së Financës për kontabilizim.
3. Një kopje e këtij vendimi i dërgohet Zyrës së Mbikëqyrjes Doganore për pasqyrimin e këtij vendimi në sistem.
4. Bazuar në nenin 281 dhe 282 e Kodit Doganor, kundër këtij vendimi lejohet të bëhet ankim tek Drejtori i Përgjithshëm i Doganave brenda 30 ditëve nga marrja dijeni për këtë vendim.

KRYETAR

Aida DIZBARI

